<p>2. Proceset efektive të monitorimit si dhe mungesa e strategjisë gjithëpërfshirëse të zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) nuk janë të vendosura nga Komuna. Komuna gjatë vitit 2016 kishte raportuar në MF progresin fizik dhe financiar sipas kërkesave të ligjit të buxhetit, po ashtu janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.3.1;</p> <p>3. Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuar nga vetëvlerësimi i vitit 2016 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.</p>	<p>dokumentacionin mbështetës. Ne do të sugjeronim që lista kontrolluese të mos i dorëzohet MF-së para se të rishikohet nga auditimi i brendshëm.</p>		
<p>Çështja 4 - Planet strategjike - Prioritet i lartë Komuna ka një plan të përgjithshëm të zhvillimit, por nuk ka qartësuar përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e tij, si dhe mungon llogaritja e kostove të planit zhvillimore. Komuna ka një plan të hartuar kundër korrupsionit, por kërkesat nga ky plan ende nuk kanë filluar të adresohen.</p>	<p>Kryetari duhet hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes. Të siguroj se do të përgatitet edhe plani kundër korrupsionit i cili do të zbatohet sipas kërkesave, dhe si i tillë do të bëhet funksional për një qeverisje më efektive.</p>	<p>Planet ekzistuese do të funksionalizohen duke bërë llogarinë e kostove të planeve zhvillimore nëpërmjet KABK-ve për periudhat tre (3) vjeqare.</p>	<p>Intervali i procesit buxhetorë Maj - Shtator</p>
<p>Çështja 5 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek</p>	<p>Edhe pse raportimet rreth kontrolleve menaxheriale nuk kanë munguar, sidomos ato financiare për</p>	<p>Përgjatë vitit fiskal</p>

<p>shpenzimet, të hyrat, të arkëtueshmet dhe të pagueshmet, tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Ngjashëm, synimet operationale nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.</p>	<p>menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017.</p>	<p>menaxhmentin e lartë, raportet mbi progresin fizik dhe operativ gjatë vitit të njejtat do ti azhurnojmë duke synuar që ato operatione të menaxhohen në mënyrë sistematike.</p>	
<p>Çështja 6 - NJAB dhe komiteti i auditimit - Prioriteti i lartë</p> <p>E gjetura Sipas planit strategjik për auditim të brendshëm për vitin 2016 janë planifikuar të realizohen gjithsej 10 auditime, ndërsa në planin vjetor 2016 janë përfshirë gjashtë (6) auditime, të cilat janë realizuar brenda vitit. Tre (3) nga këto auditime janë vlerësuar me rrezik të lartë, dy (2) me rrezik të mesëm dhe një (1) me rrezik të ulët. Mos përmbushja e aktiviteteve audituese në harmoni me planin strategjik ka rezultuar nga mungesa e kapaciteteve njerëzore në NJAB. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet finale të aktiviteteve të përfunduara të auditimit të NJAB pritet të bëhet nga drejtuesit e njësive përgjegjëse të audituara, por që të njëjtat plane nuk ishin përgatitur.</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e udhëzimeve ligjore, lidhur me organizimin e përbërjes së strukturës organizative të NJAB, respektivisht fuqizimin e rolit të shërbimeve të auditimit të brendshëm. Gjithashtu, të siguroj zbatimin e rekomandimeve të NJAB nga drejtoritë përgjegjëse të sistemeve të audituara, si dhe Komiteti i auditimit të hartoj raportin vjetor në harmoni me Udhëzimin Administrativ 11/2010.</p>	<p>Do të siguro që komiteti i auditimit të jetë funksional dhe të kryen detyrat e veta siq kërkohet me ligj të vendos politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë të monitorimit dhe zbatim të sistemit të kontrollit të mbrendshëm në proqesin e raportimit financiar dhe zbatimin e rekomandimeve të NJAB. NJAB do të plotësohet me staf të mjaftueshëm në mënyrë që plani strategjik për auditim të brendshëm të realizohet ashtu siq kërkohet, duke u fokusuar para se gjithash në prioritetet e larta.</p>	<p>Përgjatë vitit fiskal</p>

<p>Çështja 7 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i lartë</p> <p>E gjetura Komuna ka treguar një efikasitet të lartë në realizimin e buxhetit pothuajse në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Mirëpo, një ngecje në krahasim me kategoritë tjera, vërehet për investime kapitale (85%). Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit dhe kontrollit sistematik buxhetor të komunës në realizimin e projekteve kapitale sipas planit dinamik. Kjo u dëshmuar edhe nga 7 projektet e planifikuara, të cilat nuk kishin filluar fare në vitin 2016.</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar, sidomos për projektet kapitale.</p>	<p>Vendosja e projeksioneve mbi grumbullimin e të hyrave vetanake nga MF përmes Qarkoreve Buxhetore jashtë kapaciteteve të mundshme, kanë ndikuar që realizimi i buxhetit të mos realizohet në tërësi, sidomos te projektet kapitale.</p>	<p>Vitet 2017 - 2019</p>
<p>Çështja 8 - Dobësi në menaxhimin e tatimit në pronë - Prioritet i mesëm</p> <p>E gjetura Komuna nuk kishte arritur të bëjë ri-anketimin për verifikimin 1/3 e pronave të regjistruara ashtu, siç kërkohet me udhëzimin administrativ 03/2011. Verifikimi ishte bërë vetëm për 709 nga 2900 prona të regjistruara apo mbi 24%.</p>	<p>Kryetari duhet të vendos kontrole mbi verifikimin e pronave, ndryshimet të përcillen në kohë dhe ngarkesat për tatimpaguesit të jenë të sakta, me qëllim të realizimit korrekt të tatimit në pronë.</p>	<p>Plani për rianketim dhe verifikim është hartuar dhe ka filluar të zbatohet me fillim të vitit fiskal 2017. Sipas planit është paraparë që të verifikohen gjithësej 2949 prona për vitin 2017. Realizimi deri në pjesën e parë të vitit 2017 ka arritur në 928 prona të verifikuara dhe 218 prona të regjistruara, gjithësej 1146 prona, apo afër 40% e planifikimit. Bazuar në dinamikën e punimeve të deritanishme, Udhëzimi Administrativ 03/2011 do të arrihet të aplikohet në tërësi.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>
<p>Çështja 9 - Vonesa për leje ndërtimi - Prioritet i lartë</p> <p>E gjetura Sipas të dhënave të Thesarit të hyrat për leje ndërtimi për periudhën vitin</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se shërbimi i urbanizmit do t'i shqyrtoj të gjitha kërkesat, vetëm pasi të</p>	<p>Problemet që kanë shkaktuar vonesat në shqyrtimin e lejeve të ndërtimit kanë qenë se pronat private në</p>	<p>Përgjatë vitit</p>

<p>2016 ishin 11,206€ apo 56% me pak se vitin paraprak. Me rastin e rishikimi të evidencës për leje ndërtimi, kemi gjetur se prej 17 kërkesave, 5 prej tyre nuk ishin shqyrtuar në afat prej 30 ditë pas pranimit të kërkesës, por ishin ende ne proces. Po ashtu, nuk ka një sistemim të dokumentacionit për të vërtetuar se dosja e rishikuar përmban të gjitha dokumentet e kërkuara.</p>	<p>njëtat të jenë të kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse të cilat kërkohen për një leje ndërtimi si dhe të siguroj se komisioni për shqyrtimin e kërkesave do të zbatoj afatin prej 30 ditësh nga pranimi i kërkesës, në mënyrë që shërbimet të jenë të shpejta dhe të sakta ndaj qytetarit.</p>	<p>zonën urbane te qytetit sipas ligjeve të periudhes se paraluftës, konkretisht te vitit 1980 ishin të regjistruara si prona shoqërore. Pas paraqitjes së këtij problem në instancat më të larta Qeveritare dhe në bazë të nje rekomandimi të Kuvendit Komunal ne kemi filluar ta zhbllokojmë këtë situatë dhe se kërkesat e reja shqyrtohen me kohë.</p>	
<p>Çështja 10 - Mos arkëtimi i qirasë nga pronat publike - Prioritet i lartë</p> <p>E gjetura Të hyrat e planifikuara nga shfrytëzimi i pronës publike për vitin 2016 ishin 25,000€ deri sa ishin inkasuar 15,938€. Pavarësisht shkallës së inkasimit, me rastin e testimit tetë (8) rasteve kemi gjetur se komuna më 08.01.2016 ka vazhduar kontratën me qiramarrësit e pronës publike, edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet paraprake. Zyrtari përgjegjës mbanë evidencë për të gjitha pronat e dhëna me qira, mirëpo kjo evidencë nuk ka informata të mjaftueshme për të siguruar se të gjitha vlerat janë të llogaritura saktë dhe drejtë. Kësaj evidence i mungonin informatat për saldon e bartur të borxhit nga viti paraprak si dhe informatat për datën e kontraktuar, përfshirë këtu edhe periudhën e shfrytëzimit të pronës komunale.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se nuk do bëhet vazhdimi i kontratave me qiramarrësit që nuk i kanë kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura. Gjithashtu, të kërkoj nga zyrtari përgjegjës të krijoj një evidencë të qartë dhe të kompletoj atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi qirave të jetë më efikas.</p>	<p>Do të Mirren gjitha masat e duhura që inkasimi per shfrytezimin e pronës komunale të realizohet më për së afërmi me planifikimet, kjo do te arrihet me leshimin e verejtjeve tek shfrytezuesit e ketyre pronave ne fillim te vitit dhe te njejteve nuk do t'iu vazhdohet leja e shfrytezimit pa I kryer obligimet paraprake.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>
<p>Çështja 11 - Ekzekutimi i pagës pas skadimit të kontratës së punës -</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e</p>	<p>Do të ndermirren gjitha hapat e</p>	<p>Periudha e paraparë</p>

<p>Prioritet i mesëm</p> <p>E gjetura Në një rast kemi evidentuar se një i punësuar në departamentin e shërbimeve të shëndetësisë primare është paguar me pagë në muajin pasues pas skadimit të kontratës së punës, ndërsa marrëdhënia e punës i është ndërprerë me aktvendim pas pranimit të pagës, respektivisht në fillim të muajit të dytë pas skadimit të kontratës.</p>	<p>veprimeve të nevojshme për respektimin e procedurave për largimin me kohë nga sistemi i pagave të personave të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës.</p>	<p>nevojshëm per zbatimin e ketij rekomandimi.</p>	<p>per dorezimin e ndryshime ve ne paga, konkretish nga dt.01-10 e çdo fillim muaji vijues.</p>
<p>Çështja 12 - Licencat e punës së personelit shëndetësor - Prioritet i mesëm</p> <p>E gjetura Në dy raste kemi evidentuar se personeli shëndetësor në departamentin e shërbimeve të shëndetësisë primare, nuk i kanë licencat e punës të azhurnuara apo të ripërtëritura me afat kohor valid, të cilat shërbejnë për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur dhe në harmoni me rregullat ligjore, përderisa aktualisht posedojnë licenca të punës me afat të skaduar.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e kërkesave ligjore, lidhur me ri licencimin sipas nevojës të personelit shëndetësor, në pajtueshmëri me Udhëzimin Administrativ përkatës për regjistrimin dhe licencimin e profesionistëve shëndetësor.</p>	<p>Ministria e Shendetesisë (MSH) ka bërë në formë grupore ka bërë ri-licencimin per te gjithë personelin shendetesorë deri ne vitin 2009, ndersa pas ketij viti ri-licencimin e bënë ne formë të Dekretit I cili vlene deri në fund të vitit 2017.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>
<p>Çështja 13 - Mangësi në zbatimin e kontratave dhe kryerjen e pagesave - Prioritet i Lartë</p> <p>E gjetura Komuna kishte lidhur një kontratë me datën 02.02.2016 në shumë prej 53,810€ për mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Më 17.03.2016 komuna kishte paguar OE “në shumë 13,130 për një faturë të datës 26.02.2016 në emër të situacionit të parë për mirëmbajtjen e rrugëve verore dhe dimërore. Ne nuk kemi gjetur se organi mbikëqyrës ka konfirmuar me shkrim rregullsinë e situacionit të parë. Sipas analizës kemi vërejtur se komuna brenda 6 muajve ka realizuar këtë projekt, edhe pse kishte lidhur kontratë një vjeçare. Kjo është si rezultat i mos planifikimit te</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e projekteve përgatitin për çdo situacion raporte me shkrim duke specifikuar saktë rrugën apo lokacionin ku janë kryer punimet, si dhe të konfirmojnë sasisë dhe cilësinë e punëve. Po ashtu, duhet të siguroj as asnjë shpenzim nuk është certifikuar pa kontratë përkatëse.</p>	<p>Do të shtohet kontrolli nga menaxherët e caktuar per zbatimin e kontratave dhe kontrolli ne certifikimin e dokumentacionit per pagesë.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>

<p>duhur të shpenzimeve sepse komuna ka nevojë për tërë vitin të kryej mirëmbajtjen verore dhe dimërore. Kjo i ka kushtuar kosto shtesë komunës duke lidhur edhe një kontratë me një operator tjetër.</p> <p>Më datën 19.02.2016 është paguar shuma 3,600€ në emër të shërbimeve të kryera nga Policia e Kosovës. Sipas listës së ofruar nga policia, ne nuk kemi gjetur se ku janë kryer këto shërbime.. Marrëveshja është lidhur më datën 15.07.2015 nga tre palët: komuna, policia dhe agjencia pyjore për një periudhë katër (4) mujore me çmim 2.5€/h, ku qëllimi i kësaj marrëveshje ishte parandalimi dhe mbrojtja nga asgjësimi i pyjeve. Sipas rishikimit analitik për vitin 2016 ishin paguar 21,120€ në emër të shërbimeve të kryera. Ne nuk kemi gjetur dokument tjetër për vazhdimin e kontratës.</p> <p>Me rastin e testimin të pagesës prej 4,600€ në emër të eliminimit të qenve endacak, kemi vërejtur se Komuna nuk posedon dëshmi të mjaftueshme për formën e trajtimit të qenve të eliminuar. Ne kemi gjetur listën me numër prej 250 qenve të zënë, por jo edhe procesin nëse këta janë dërguar për trajtim të mëtutjeshëm apo janë eliminuar.</p>			
<p>Çështja 14 - Shpenzimet për shërbime komunale - Prioritet i mesëm</p> <p>E gjetura Me datën 29.04.2016, ishte lidhur marrëveshja në mes Kryetarit të komunës dhe KRM "Pastërtia" nga Ferizaj për kryerjen e shërbimeve të kërkuara nga komuna e Kaçanikut. Me datën 24.11.2016 është paguar shuma prej 6,600€ në emër të shërbimeve lidhur me asgjësimin dhe groposjen e gjedheve të ngordhura. Sipas faturës ishin kryer shërbime për 60 sosh me çmim prej 110€ për copë. Ne në bazë të dokumentacionit të ofruar nuk kemi gjetur se në kuadër të marrëveshjes është cekur çmimi i faturuar prej 110€ për copë.</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se me rastin e çfarëdo marrëveshje të merret parasysh edhe kosto për shërbime dhe në rast se çmimi i ofruar nuk është i arsyeshëm te kërkoj shërbime nga ndonjë operator tjetër me kosto optimale shërbimi.</p>	<p>Rasti konkret ka qenë rast i jashtëzakonshëm dhe i pamundur te planifikohet se do te ndodhë "Sëmundja gungore e gjedheve" Për groposjen e gjedheve të ngordhura është angazhuar kompania KRM Pastërtia sh.a.</p>	<p>Përgjatë vitit sipas rasteve të paraqitura</p>

<p>Çështja 15 - Ndarja e subvencioneve - Prioritet i mesëm</p> <p>E gjetura Te subvencionet e ndara për Klubin e Futbollit Lepenci, sipas pagesës së datës 27.09.2016 në vlerë 1000€ kemi vërejtur se mungojnë kërkesat e arsyetuara nga entitetet përfituese për shpenzimin e mjeteve financiare të përcaktuara sipas kriterëve të Rregullores së brendshme për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për respektimin e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e brendshme, për sigurimin e kërkesave të mirë arsyetuara nga entitetet përfituese, me rastin e marrjes së vendimit për ndarjen e mjeteve financiare.</p>	<p>Gjatë vitit 2017 OB-ja është duke aplikuar rregulloren e re mbi ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, e cila parashehë qartë se duhet te behen kërkesa perkatese dhe te njejtat te arsyetohen me dëshmi relevante.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>
<p>Çështja 16 - Lidhja e kontratës për punë shtesë - Prioritet i lartë</p> <p>E gjetura Me testimin e nëntë (9) mostrave nga investimet kapitale në shumë 539,923€, kemi gjetur se në pesë (5) raste ishin lidhur aneks kontrata për punë shtesë në shumë 10,935€. Aneks-kontratat nuk ishin lidhur për shkak të punëve të paparashikuara, por si rezultat i mos planifikimit të duhur dhe përgatitjes së paramasave dhe parallogarive.</p>	<p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se paraprakisht janë rishikuar të gjitha paramasat dhe parallogaritë për projekte kapitale në mënyrë që realizimi i projekteve, sa herë që është e mundur, të bëhet vetëm me kontratën bazë.</p>	<p>Gjatë shpalljeve të thirrjeve për punë të ndryshme nga Zyra e Prokurimit do të kërkohej që nga njësitë kërkuese të sigurohen projekte, paramasa më të detajuara dhe të sakta si ne aspektin sasiorë dhe te kostove në mënyrë që tek projektet e vogla te mos perseriten puet shtesë.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>
<p>Çështja 17 - Sigurimi i tenderit për afat më të shkurtër sesa afati i kontratës - Prioritet i lartë</p> <p>E gjetura Tek kontrata për projektin „Ndërtimi i rrugës“ në fshatin Biqec në vlerë 24,605€, kemi vërejtur se operatori ekonomik fitues nuk kishte sjellë sigurimin e tenderit sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Kërkesa ishte që sigurimi i tenderit të bëhej për 90 ditë, ndërsa ishte paguar vetëm për 60 ditë.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se gjatë çdo aktiviteti të prokurimit respektohet LPP dhe kriteret e caktuara në dosje të tenderit janë plotësuar nga OE pjesëmarrës.</p>	<p>Zyra e Prokurimit do te siguroj se do te respektohet LPP në përpikëri.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>

<p>Çështja 18 - Sigurimi i ekzekutimit - Prioritet i Lartë</p> <p>E gjetura Me datën 18.03.2016 ishte lidhur kontratë për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve në shumën vjetore prej 11,750€. Sipas kriterëve të dosjes së tenderit fituesi do duhej të paguaj 10% nga vlera e kontratës në emër të sigurimit të ekzekutimit. Ne nuk kemi gjetur se ky kriter është plotësuar nga fituesi.</p>	<p>Kryetari i komunës duhet të siguroj se zyra e prokurimit do t'i respektoj të gjitha kriteret e tenderimit dhe në rast të shkeljes apo mos zbatimit të kriterëve, të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përkatësisht nga menaxheri i prokurimit.</p>	<p>Zyra e Prokurimit do te siguroj se do te respektohet LPP në përpikëri.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>
<p>Çështja 19 - Tejkalmi i korrigjimit të vlerës së ofertës - Prioritet i mesëm</p> <p>E gjetura Me datën 09.11.2016 është lidhur kontratë me operatorin ekonomik në shumë prej 8,227€, deri sa oferta e tij ishte 8,827€. Ne nuk kemi gjetur se komisioni për vlerësim të ofertave ka lënë gjurmë për korrigjime të kësaj oferte. Për më tepër, vlera e kontratës ishte për 600€ më e ulët nga oferta financiare. Shkalla prej 7% ka tejkaluar shkallën prej 2% të lejuar paraqet shkelje të rregullave të dala nga Ligji për Prokurim Publik.</p>	<p>Kryetari i komunës duhet të siguroj se zyra e prokurimit, përkatësisht komisioni për vlerësim të ofertave do t'i respektoj të gjitha kriteret e dosjes së tenderit si dhe kërkesat tjera ligjore dhe në rast të shkeljes apo mos zbatimit të kriterëve, të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët, përkatësisht nga menaxheri i prokurimit.</p>	<p>Zyra e Prokurimit do te siguroj se do te respektohet LPP në përpikëri dhe zbatimin e kriterëve që dalin nga kërkesat tjera ligjore të kë kësaj lëmie.</p>	<p>Përgjatë vitit</p>
<p>Çështja 20 - Bashkëfinancimet dhe pagesat tjera - Prioritet i lartë</p> <p>Në vitin 2016, Komuna kishte paguar shumën 97,428€ në llogari të OJQ „Kosova Luxemburg“ si bashkë financues në tri projektet e fituara, për: (1) Zhvillimi i komuniteteve, (2) Mbështetje për bizneset fillestare dhe</p>	<p>Kryetari duhet të përmirësoj procesin e planifikimit dhe të sigurojë monitorim të këtyre marrëveshjeve që nga inicimi deri në realizimin e plotë të tyre për të parandaluar</p>	<p>Do të shtohen perpjekjet qe gjatë bashkefinancimit te projekteve me donatoret e ndryshëm të sigurohemi se këto bashkëfinancime do te kodohen në kodet</p>	<p>Përgjatë vitit</p>

<p>ekzistuese, dhe (3) Zhvendosja e personelit të QKMF. Ne kemi testuar të gjitha pagesat dhe në kuadër të pagesave kemi gjetur se shumica prej 25,000€ e paguar në llogari të donatorit ishte bërë në bazë të një aneksi për ndërtimin e kulmit të shkollës në fshatin Stagovë, deri sa nuk kemi gjetur të bashkëngjitur paramasën dhe parallogarinë e projektit. Shumica tjetër prej 25,728€ ishte bërë në emër të projektit për asistencë bizneseve fillestare dhe ekzistuese. Paga tjetra ishte bërë për donatorin sipas projektit „Zhvillimi i komuniteteve“ duke prezentuar raport për ndihmë me mjedra për 15 përfitues dhe sistem pikësh për 16 përfitues të tjerë. Komuna ka paguar dhe regjistruar gabimisht si avance për investime, ndërsa këto pagesa i takojnë kategorisë për subvencione dhe transfere dhe jo kategorisë për investime kapitale. Raste të tilla të pagesave nga kategoria për investime kapitale janë gjetur në të gjitha pagesat tjera të përfshira në shumën totale prej 97,428€.</p>	<p>pagesat për subvencione dhe transfere nga buxheti për investime kapitale</p>	<p>përkatese të pasurisë.</p>	
<p>Çështja 21 - Përdorimi i E-pasurisë jo në mënyrë funksionale - Prioritet i lartë</p> <p>E gjetura Komuna e Kaçanikut e përdorë softuerin “e-Pasuria” për t’i regjistruar pasuritë jo financiare nën 1,000€ dhe stoqet. Sipas zyrtarit ky sistem nuk është mjaft funksional për shkak të mos përllogaritjes së zhvlerësimit.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se e-pasuria do të funksionoj në kapacitete të plota, dhe me rastin e planifikimit të buxhetit të merren informata të sakta për pajisjet e amortizuara, në mënyrë që të mundësohet zëvendësimi i tyre në kohën e duhur duke shmangur problemet me aktivitetet operative të komunës.</p>	<p>Do të mirren masa që të trajnohen zyrtarët për menaxhim më të mirë të sistemit “e-Pasuria”</p>	<p>Përgjatë vitit</p>
<p>Çështja 22 - Depozita në bankë - Prioritet</p>	<p>Kryetari duhet të</p>	<p>Depozitimi në baza</p>	<p>Përhershëm</p>

<p>i lartë</p> <p>E gjetura Sipas rregullave financiare, të gjitha mjetet deri në 10€ mund të mbliidhen nga komuna në të gatshme. Mirëpo, në fund të ditës ato duhet të derdhen në bankë së bashku me dokumentin përmbledhës të përcaktuar si numër identifikues me UNIREF. Testimi i depozitës së mjeteve prej 1,942€ është bërë me 21.03.2016 deri sa këto mjete janë mbledhur prej datës 14.03 - 18.03.2016. Kjo praktikë është e zakonshme në komunën e Kaçanikut.</p>	<p>siguroj se një praktikë e tillë do të ndërpritet, dhe të zbatohen kërkesat e rregulloreve financiare që të gjitha shumat e mbledhura në kesh, të depozitohen në bankë brenda afateve ligjore të përcaktuara.</p>	<p>ditore e jo javore siq është vepruar deri më tani përkundër shpenzimeve të panevojshme që mundë bëhen në emër të provizioneve me rastin e depozitimit të parasë në baza ditore.</p>	<p>e</p>
<p>Çështja 23 – Rritja e vazhdueshme e borxheve të pa mbledhura - Prioritet i lartë</p> <p>E gjetura Edhe pse të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave vetjake, ato në fund të vitit 2016 kanë rezultuar me një borxh të pa arkëtuar prej 1,002,540€. Rast tjetër me rëndësi, ishte edhe me borxhet nga taksa në firmë ku në fund të vitit 2016 ishin të pa arkëtuara 204,280€, ndërsa ato të qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale ishin 82,860€. Këto tre lloje ishin prezentuar si llogari të arkëtueshme në fund të vitit. Ne nuk kemi vërejtur se komuna ka ndonjë strategji konkrete për inkasimin/ zvogëlimin e të arektueshmeve. Për vitin 2016 komuna ka ngarkuar taksën në firmë për biznese në shumë 42,850€, deri sa të hyrat e inkasuara për vitin 2016 ishin 23,844€ apo 56% nga plani. Evidenca e mbajtur nga zyrtari përgjegjës përmban vetëm ngarkesën vjetore deri sa kjo evidencë nuk përmban edhe saldon nga viti paraprak. Sipas raportit financiar në fund të vitit 2016 kishin mbetur si llogari të arkëtueshme shuma prej 204,290€. Ne nuk ishim në gjendje të verifikojmë këtë shumë për shkak të evidencës së mangët të mbajtur nga zyrtari përgjegjës. Për më tepër, komuna kishte marrë disa veprime të kufizuara, por nuk ka ndonjë strategji gjithëpërfshirëse për inkasimin e këtyre të</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se evidencat për të gjithë tatimpaguesit do të azhurnohen dhe të kompletohen me të gjitha informatat e nevojshme dhe të analizoj shkaqet për inkasim të ulët, si dhe të krijoj mekanizma për rritjen e inkasimit. Po ashtu, të gjej zgjidhje praktike për borxhet e mbetura nga qiramarrësit e lokaleve të rrënuara.</p>	<p>Meqë pjesa më e madhe e zërit LL/A ka të bëjë me obligimet e qytetareve ndaj Tatimit në Pronë, komuna do të angazhohet që deri në datën e fundit (03.09.2016) të shfuqizimit të Ligjit mbi faljen e Borgjeve Publike të bëjë përpjekje që ky Ligj të zbatohet në masë sa më të madhe si nga aspekti i shtimit të arkëtimit të të hyrave vetanake komunale, pastrimit të listës së LL/A dhe në të mirë të qytetarëve nga falja që mundë gëzojnë. Angazhimi kryesisht do të bëhet në drejtim të informimit të qytetareve për të drejtat që i jep Ligji në fjalë dhe apelimit të për shlyerje të obligimeve të tyre. Pjesa tjetër e LL/A të cilat nuk trajtohen me</p>	<p>Përhershme</p>

<p>arkëtueshmeve. Rasti tjetër, ishte edhe me lokale të cilat komuna me një vendim të Kuvendit të datës 03.05.2012 kishte rrënuar rreth 26 lokale të vjetra me qëllim të ndërtimit të parkut të qytetit. Shuma e pa arkëtuar nga qiramarrësit në fund të vitit 2016 ishte 33,325€. Komuna nuk ka analizuar dhe shqyrtuar mundësinë e inkasimit të kësaj shume nga qiramarrësit.</p>		<p>Ligjin mbi Faljen e borgjeve, komuna së pari do të angazhohet ne gjetjen e menyrave të inkasimit të rregullt të tyre e më pas do të bëjë analiza mbi mundësinë apo jo të arkëtimit të tyre dhe pas identifikimit apo klasifikimit si "borgje të këqija" të asaj pjese të LL/ A ,do të bëjë edhe heqjen e tyre nga regjistrat komunale permes procedurave ligjore tjera.</p>	
<p>Çështja 24 - Menaxhim i dobët i detyrimeve - Prioritet i lartë</p> <p>E gjetura Sipas një analize, del se komuna në vitin 2016, ka paguar fatura të vitit 2015 në shumë prej 126,590€, deri sa faturat e papaguara te prezantuara në fund të vitit 2015 ishin 69,400€. Sipas kësaj analize del se komuna nuk ka prezantuar drejt obligimet e saj duke shkaktuar nënvlerësimin e tyre prej 57,190€; Komuna nuk kishte pasur një plan të mirëfilltë të rrjedhës së parasë për pagesën e obligimeve të ndodhura. Në fund të vitit 2016 ishin regjistruar obligime nga kategoria subvencione dhe transfere në shumë 14,150€ deri sa shuma e mbetur e buxhetit për këtë kategori ishte 1,021€. Pra, është tejkalluar buxheti për këtë kategori në shumë prej 13,129€. Si çështje për vëmendje do të mbetet në auditimin e radhës për të rishikuar nëse ka fatura të paguara dhe të pa prezentuara nga komuna.</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se ekziston një raportim i drejtë dhe në kohë i të gjitha faturave të papaguara nga të gjitha departamentet, si dhe duhet të siguroj se planifikimi i buxhetit bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkalluar në asnjë rast ndarjet buxhetore.</p>	<p>Do të mundohemi të jemi të fokusuar që të jemi në plotni të zbatimit të ligjit që mos të mbeten mbi 30 ditë faturat e papaguara, duke u kujdesur që të mos kalohen në asnjë rast ndarjet buxhetore.</p>	<p>Përhershm e</p>